

Mbi Auditimin e Ushtruar në Universitetin Bujqësor Tiranë

Auditimi u ushtrua nga grupi i Auditimit pranë Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm të KLSH

Raporti Përfundimtar i Auditimit Tematik: “Për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare” të ushtruar në Universitetin Bujqësor Tiranë për periudhën nga data 01.01.2011 deri më datë 30.09.2013 dhe **Rekomandimet janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH nr. 43 datë 30.04.2014. (nr. 956/8 prot. datë 30.04.2014)**

Auditimi u realizua sipas Programit të Auditimit nr. 956/1 datë 21.11.2013 nga Grupi i Auditimit: Muhamed Kavaja (përgjegjës grupi, Marjola Lleshi anëtar, Anila Halili anëtarë, Dritan Kore anëtarë dhe Ildir Dervishi anëtarë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme

Është rekomanduar një propozim për përmirësim legjislativ si më poshtë:

-Universiteti Bujqësor i Tiranës në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të kërkojë një ndërhyrje ligjore në nenin 50 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, që do të përcaktonte qartë rastet specifike, procedurat që do të ndiqen, vlerësimet dhe afati i shtyrjes së daljes në pension, statusi i këtyre personave, si dhe vendimmarrja kolegjiale e Dekanit dhe Rektorit për çdo rast.

Janë Rekomanduar tridhjetë masa organizative

Janë rekomanduar masa për Shpërblim dëmi:

Mbështetur në nenin 27, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Për Kodin e Punës” me ndryshimet e mëvonshme, janë rekomanduar të nxirren urdhrat për shpërblim dëmi, të kryen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat si më poshtë:

1-Nga auditimi u konstatua se objektet në pronësi të UBT-s dhënë me qira subjekteve private nuk ka gjetur zbatim VKM-në nr.529, datë 08.06.2011 në, kreun II, pika ç) ku citohet: “*genplanin e objektit origjinal, ku të jenë shënuar sip. e truallit, gjithsej, sip. e truallit nën ndërtesë dhe sip. e truallit të lirë funksional (jo nën ndërtesë),në territorin e së cilës ndodhet pasuria*” inxhinjeri nuk ka llogaritur sip. nën ndërtesë dhe atë funksionale dhe ka hequr nga llogaritjet trashësinë e mureve, gjë që ka sjell diferencë në pagesën e kontratës për sipërfaqen totale në m²:

Për sa më lartë është rekomanduar:

-Të plotësohet i gjithë dokumentacioni i subjektit- R, K si dhe të paguaj detyrimin prej **37,260 lekë** në momentin e rinovimit të kontratës.

-Të plotësohet i gjithë dokumentacioni i subjektit- S.Sh si dhe të paguaj detyrimin prej **131,760 lekë** në momentin e rinovimit të kontratës.

-Të plotësohet i gjithë dokumentacioni i subjektit- E.I. si dhe të paguaj detyrimin prej **112,615 lekë** në momentin e rinovimit të kontratës.

-Të plotësohet i gjithë dokumentacioni i subjektit- V.J. si dhe të paguaj detyrimin prej **253,110 lekë** në momentin e rinovimit të kontratës.

-Të plotësohet i gjithë dokumentacioni i subjektit- E.B. si dhe të paguaj detyrimin prej **177,680 lekë** në momentin e rinovimit të kontratës.

-Të plotësohet i gjithë dokumentacioni i subjektit- D.A. si dhe të paguaj detyrimin prej **427,020 lekë** në momentin e rinovimit të kontratës.

-Të plotësohet i gjithë dokumentacioni i subjektit- F.R. si dhe të paguaj detyrimin prej **604,800 lekë** në momentin e rinovimit të kontratës. Të rregjistrohet në organet tatimore për tu paisur me NUIS(nipt)

2-Nga auditimi i shpenzimeve të karburantit dhe përdorimit të tij në tre Fakultetet e UBT rezultuan diferenca me dëm ekonomik. Për sa më lartë u rekomandua:

-Nga UBT të merren të gjithë masat e duhura ligjore për shpërblimin e dëmit prej **1,340,863 lekë** nga personat e mëposhtëm sipas Fakulteteve:

-Për Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit (FBM), për periudhën e auditimit ka një diferencë sasive karburanti në përdorimin e gjeneratorit, prej: **6711 litra në vlerën 1,174,071 lekë nga dy persona.**

-Për Fakultetin e Mjeksisë Veterinare (FMV), për periudhën e auditimit ka një diferencë sasive karburanti në përdorimin e gjeneratorit, prej **68 litra, në vlerën 13,495 lekë** nga një person.

-Për Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA/B), për periudhën e auditimit ka një diferencë sasive karburanti në përdorimin e gjeneratorit, prej **873 litra, në vlerën 153,297 lekë nga tre persona.**

3-Nga auditimi i listëpagesave të personelit akademik të ftuar rezultoi :se në çdo rast është kryer ndalesa e tatimit mbi të ardhurat personale, por në asnjë rast nuk është bërë ndalesa për sigurimet shoqërore deri në kufirin e lejuar (Si diferencë e ndalesës së kryer pranë qendrës së parë të punës dhe kufirit maksimal). Kjo bie në kundërshtim me VKM nr.1114, datë 30.07.2008, “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.9136,datë 11.09.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,dhe ligjit nr.7870, datë 13.10.1994, “Për sigurimet shëndetsore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku në Kapitullin e V “Pagesa e Kontributeve”, pika 3,thuhet: “Për rastet kur i njëjti person është ekonomikisht aktiv në dy ose më shumë subjekte, pagesa e kontributit është e detyrueshme në çdo subjekt, sipas pagës, por jo më shumë se kontributi maksimal.”

Kështu nga përlllogaritjet e bëra rezulton se për 88 punonjës së ftuar, shumata totale e ndalesës së llogaritur për t’u mbajtur është 663,056 lekë, e cila e ndarë sipas viteve në mënyrë analitike paraqitet në aneksin bashkëlidhur këtij projektraporti.dhe krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit

Gjithashtu UBT (Punëdhënësi) nuk ka llogaritur dhe derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore (16,7%) deri në kufirin e lejuar (Si diferencë e ndalesës së kryer pranë qendrës së parë të punës dhe kufirit maksimal).

Për sa më lartë është rekomanduar:

-Nga UBT të merren të gjithë masat e duhura ligjore për shpërblimin e dëmit **663,056 lekë** dhe derdhjen e detyrimit në institucionin përkatës sipas listës bashkëlidhur këtij **raporti.**

Institucioni i UBT për të gjithë punonjësit e ftuar Akademik të llogarisë dhe të derdhë kontributin e sigurimeve shoqërore në masën 16,7% të kufirit maksimal për punonjësit e Ftuar

Akademik (si diferencë midis kufirit maksimal dhe sigurimit shoqëror të derdhur nga institucioni ku punonjësit janë ekonomikisht aktiv).

4- Nga auditimi që ju bë listëpagesave të personelit akademik në zbatim të Ligjit nr.10139, datë 15.05.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, qendrës së studimeve albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, u konstatua se stafit akademik që gëzon titullin shkencor ‘Profesor’, dhe “Profesor i asociuar” kishte mangësi në lidhje me ndalesën e sigurimit suplementar të mbajtur, pasi ndalesa e sigurimit është mbajtur vetëm mbi pagën mujore të punonjësve, dhe jo mbi gjithë të ardhurat e realizuara , (ku përfshihen edhe pagesat për orët shtesë të paguara).

Kështu nga përllogaritjet e bëra rezultoi se shuma totale e ndalesës së llogaritur për t’u mbajtur (si diferencë e detyrimit për t’u mbajtur dhe atij të mbajtur në fakt) është **4,758,042 lekë**, e cila në mënyrë analitike e ndarë sipas viteve për çdo Fakultet të UBT paraqitet sipas tabelës bashkëlidhur këtij Raporti.

Për sa më lartë është rekomanduar:

-Nga UBT të merren të gjithë masat e duhura ligjore për shpërblimin e dëmit prej **4,758,042 lekë** dhe derdhjen e tij në institucionet përkatëse, sipas listës bashkëlidhur Raportit përfundimtar të auditimit.

5 Është rekomanduar:

-Nga UBT të merren të gjithë masat e duhura ligjore për shpërblimin e dëmit prej **1,416,911 lekë** lekë nga 8 punonjësit e institucionit, si përfitim të padrejtë, sipas listës bashkëlidhur Raportit.

6-Nga auditimi i punimeve të kryera në objektet e ndërtimit kanë rezultuar diferenca në zbatimin e punimeve të ndërtimit në kundërshtim me nenin 7, paragrafi i tretë, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe udhëzimin e KM nr. 1, datë 16.06.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” ***gjithsej në shumën 1,518,819.6 lekë me t.v.sh, duke i shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të institucionit.***

Për sa më lartë është rekomanduar:

- Universitetit Bujqësor i Tiranës të marrë të gjithë masat e duhura ligjore dhe kontabile për shpërblimin e dëmit prej **1,518,819.6 lekë**, punime të pakryera nga tre operator ekonomik.

7-Nga auditimi kanë rezultuar vendosje e zërave në situacionin përfundimtar sipas manualit të ndërtimit, por të cilat nuk i përkasin punimeve të kryera në objekt, në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe udhëzimin e KM nr. 1, datë 16.06.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” ***gjithsej në shumën 2, 014, 924.8 lekë me t.v.sh, duke i shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të institucionit.***

Për sa më lartë është rekomanduar:

- Universitetit Bujqësor i Tiranës të marrë të gjithë masat e duhura ligjore dhe kontabile për shpërblimin e dëmit në shumën prej **2, 014, 924.8 lekë me t.v.sh**, nga një operator ekonomikë.

8. Nga auditimi i shpenzimeve të projekteve rezultoi se shpenzimet e karburantit nuk përkonin me kohën në të cilën është bërë shërbimi, daljet e karburantit në sasi janë bërë në kohën kur projekti ka përfunduar dhe nuk justifikoheshin me dokumentacion financiar në total : **2405 litra karburant = 434 181 lekë, për tre projekte.**

Për sa më lartë rekomandoj:

Nga Drejtoria e Financës së UBT në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve të UBT-s të bëhet verifikimi i dokumentit financiar të paraqitur nga kordinatorët lidhur me shpenzimet e karburantit, në rast të kundërt të kërkohet shpërblimi i dëmit në vlerën e mësipërme.

Në bazë të nenit 37 të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe kontratës individuale të punës neni 8 dhe neni 9, i janë rekomanduar Universitetit Bujqësor Tiranë, marrja e masave disiplinore si më poshtë vijon:

-“ Largim nga puna” për: 8 nëpunës.

-“Vërejtje me paralajmërim largim nga puna” për: 6 nëpunës

Janë rekomanduar masa administrative (gjoba) si më poshtë:

Universiteti Bujqësor i Tiranës ti propozojë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, pranë Bashkisë Tiranë, mbështetur në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” me ndryshime, neni 15, për shkelje të nenit 7, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve”, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, bazuar në shkeljet e trajtuara në pikën VII të Raportit të auditimit ,*të vendosë gjobë për subjektet e mëposhtme:*

1. Shoqërisë “ _____ , gjobë në masën 500,000 lekë, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit në objektet “Rikonstruksion i Fasadës së Godinës së Agronomisë në UBT” ku është konstatuar një dëm ekonomik në vlerën **250,663** lekë pa t.v.sh ; “Rikonstruksioni i Godinës së Zooteknisë” në UBT ku është konstatuar një dëm ekonomik në vlerën **725, 800** lekë pa t.v.sh, shkaktuar si pasojë e diferencave të punimeve të kryera me punimet e situacionuara.

2. Shoqërisë “Leni-Ing” sh.p.k , gjobë në masën 100,000 lekë, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit në objektin “Rikonstruksion i Garazheve për Zyra dhe Ambjente Mësimdhënie për Departamentin e Agro-Mjedisit dhe Ekologjisë” në UBT ku është konstatuar një dëm ekonomik në vlerën **1,679,104** lekë pa t.v.sh , shkaktuar si pasojë e diferencave të punimeve të kryera me punimet e situacionuara dhe vendosjes së zërave në situacionin përfundimtar sipas manualit të ndërtimit të miratuar nga Këshilli i Ministrave, por të cilat nuk i përkasin punimeve të kryera në objekt.

3. z. _____ , gjobë në masën 50,000 lekë, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit në objektin “Ndërtim Depo uji 250 m³ dhe lidhje me rrjetin ekzistues” në UBT ku është konstatuar një dëm ekonomik në vlerën **289,220** lekë pa t.v.sh , shkaktuar si pasojë e diferencave të punimeve të kryera me punimet e situacionuara.

4. z. _____ , gjobë në masën 50,000 lekë, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit në objektin “Restaurimi i Sallës së leksioneve dhe anekseve të saj si dhe kati i dytë i godinës së Laboratorit” në UBT ku është konstatuar një mungesë e theksuar në cilësinë e kryerjes së punimeve të ndërtimit dhe materialeve të vendosura në objekt.

5. znj. _____ , gjobë në masën 200,000 lekë, në cilësinë e kolauduesit të punimeve të ndërtimit në objektet “Rikonstruksion i Fasadës së Godinës së Agronomisë në UBT” ku është konstatuar një dëm ekonomik në vlerën 250,663 lekë pa t.v.sh ; “Rikonstruksioni i Godinës së Zooteknisë” në UBT ku është konstatuar një dëm ekonomik në 725, 800 lekë pa t.v.sh , dhe është konstatuar mosrespektim i kushteve teknike të zbatimit, specifikimeve teknike të përcaktuara në projekt dhe cilësisë të dobët në punimet e ndërtimit dhe materialeve.

6. Shoqërisë _____, gjobë në masën **50,000 lekë**, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve të ndërtimit në objektin “Restaurimi i Sallës së leksioneve dhe anekseve të saj si dhe kati i dytë i godinës së Laboratorit” në UBT ku është konstatuar një mungesë e theksuar: në cilësinë e kryerjes së punimeve të ndërtimit, në cilësinë materialeve të vendosura në objekt, në mosrespektimit të kushteve teknike të zbatimit dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në projekt.

7. Shoqërisë “_____” sh.p.k, gjobë në masën **200,000 lekë**, në cilësinë e zbatuesit të punimeve të ndërtimit në objektin “Rikonstruksion i Fasadës së Godinës së Agronomisë në UBT” ku është konstatuar një dëm ekonomik në vlerën 250,663 lekë pa t.v.sh dhe është konstatuar mosrespektim i kushteve teknike të zbatimit, specifikimeve teknike të përcaktuara në projekt dhe cilësisë së dobët në punimet e ndërtimit dhe materialeve.

8. Shoqërisë “_____” sh.p.k, gjobë në masën **500,000 lekë**, në cilësinë e zbatuesit të punimeve të ndërtimit në objektin : “Rikonstruksioni i Godinës së Zooteknisë” në UBT ku është konstatuar një dëm ekonomik në vlerën **725, 800 lekë** pa t.v.sh dhe është konstatuar mosrespektim i kushteve teknike të zbatimit, specifikimeve teknike të përcaktuara në projekt dhe cilësisë së dobët në punimet e ndërtimit dhe materialeve.

9. Shoqërisë “_____” sh.p.k, gjobë në masën **200,000 lekë**, në cilësinë e zbatuesit të punimeve të ndërtimit në objektin “**Restaurimi i Sallës së leksioneve dhe anekseve të saj si dhe kati i dytë i godinës së Laboratorit**” ku është konstatuar mosrespektim i kushteve teknike të zbatimit, specifikimeve teknike të përcaktuara në projekt dhe cilësisë së dobët në punimet e ndërtimit dhe materialeve.

NGA KLSH ËSHTË BËRË KALLZIM PENAL

I. Bazuar në nenin 281 të ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë” si dhe nenin 248 “Shpërdorimi i detyrës”, të “Kodit Penal të RSH”, për z. **R. M ,znj.N. I, znj.J. K dhe z.E.T është depozituar Kallzim Penal në Prokurori pasi,**

Nga auditimi i ushtruar për shpenzimet e kryera në Ekonomine e rritjes se peshkut Tapize për periudhën objekt auditimi u konstatua se, te ardhurat janë në raport 1/10 krahasuar me shpenzimet e kryera për këtë Njësi, për vitet, 2011, 2012, 2013.

-Nga kontrolli i dokumentacionit në këtë Ekonomi u konstatua se shitja e rasatit bëhej me blerje të drejtëpërdrejte me leke në dorë, nga një komision i i përbërë nga tre persona sipas një propozimi të bërë nga znj.J. K dhe R. M dhe miratuar nga Rektori, ky komision është ngritur për shitjen e rasateve,varakëve dhe peshkut të prodhuar në këtë ekonomi, pas këtij urdhëri kordinatorja e laboratorit nxjerr urdherin e shitjes së rasateve, në të cilin është i specifikuar vetëm lloji i rasatit dhe jo sasia,në kundërshtim me Rregulloren e funksionimit të Njësisë.

Me proscverbal të komisionit është kryer shitja e rasatit me pershkrim të llojit, sasisë, cmimit dhe shumës në lekë të sasisë së shitur, bashkangjitur u gjetën fletë-daljet e sasisë së peshkut të firmosura nga komisioni dhe p/sektorit , ndërkohë qe nuk ka mandat arkëtimi nga blerësi i mallit.

Arkëtimi i shumës së parave të shitjes bashkelidhur mandat pagesat rezulton të jetë kryer nga p/sektorit , pra sa më sipër nuk vërtetohet shitja e mallit personave apo enteve private, por sipas dokumentacionit kjo shitje i është bërë P/Sektorit. Në kundërshtim me Udhëzimin nr.30 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësite e sektorit publik.

Për sa më lartë e gjithë procedura e shitjes së rasatit të peshkut është në kundërshtim me Ligjin për ankandet nr. 9874 dt 14.02.2008. si dhe me Udhëzimin nr.30 “Menaxhimit financiar të aktiveve në njësitë e sektorit Publik”.

-Nga Kontrolli i shpenzimeve të kryera në lidhje me ushqimin e peshkut në këtë Ekonomi rezultoi se per të tre vitet ka shpenzime dhe përdorim të ushqimit të peshkut të konsiderueshme si në blerje ushqimi nëpërmjet prokurimit publik dhe furnizim me ushqim nga EDE.

Kështu sipas dokumentave financiare rezulton se: me flete dalje nr. 319 datë 10.08.2011 është furnizuar njësia ekonomike Tapizë me 169 kg ushqim rasati 20-26% ;Kjo sasi ka mbuluar nevojat për ushqimin e peshkut për një periudhe 15 muaj pasi;

Njësia Tapizë me FD nr.604 datë 17.10 .2012 rezulton të jetë furnizuar me 206 kv ushqim rasati dhe hipofizë 1 gr në vlerë 1 877 280 lekë,; kjo sasi ushqimi duhet të mbulonte nevojat e ekonomisë për rreth 9 muaj deri më 4.07.2013 pasi në këtë datë rezulton e tërhequr nga EDE sasia prej 140 kv grure dhe misër si bazë ushqimore në vlerë 420 000 leke;

Me FD nr.279 date 28.05.2013 është furnizuar me 200 kg sojë kokërr me vlerë 24 000 lekë ,kjo sasi është pasuar me furnizimin e e 150 kv grurë e misër si ushqim në vlerën 466 500 lekë për vitin 2014.

Nga llogaritjet e konsumit të ushqimit rezulton sasi ushqimore e cila i kapërcen nevojat reale të konsumit që shpenzon peshku në vaskat e Tapizës.Referuar tabelës së rracionit ushqimor të paraqitur nga p/sectorit Tapizë dhe sipas ditareve të mbajtur prej tij rezulton se për vitin 2013 qëndra ekonomike Tapizë ka shpenzuar vetem 140 kv grurë në vlerën 420 mijë lekë. Pra rezulton **se sasia prej 206 kv ushqim peshku të jetë shpenzuar për rreth 2 muaj nga 17.10.2012 -31 .12.2012. Konsumi i kësaj sasive ushqimi është e pajustificuar.**

Sipas procesverbalit të mbajtur më datë 4.07.2013 nga punonjësit e ekonomisë së ritjes së peshkut të cilët përshkruajnë se është marë sasia prej 140 kv nga EDE . Sasi ushqimi kjo e përdorur për muajt Janar- Qershor 2013, ndërkohë që kjo periudhe sipas llogaritjeve duhet të mbulohej nga sasia prej 206 kv ushqim sipas FD nr.604 datë 17.10 .2012.

Për sa më lart sasia prej 140 kv nga EDE argumentuar nga N. I dhe miratuar kjo sasi gruri dhe misri nga R. M, rezulton të jetë bërë dalje nderkohe qe ushqimi ka qene disponibël sipas llogaritjeve të mësipërme.

Për sa më lartë sasia prej 206 kv ushqim peshku në vlerën 1 709 280 leke dhe 200 kg sojë kokërr në vlerën 24 000 leke rezulton e pajustificuar si konsum ushqimi për peshqit në vaskat e Tapizës.

Veprime këto në kundërshtim me rregulloren e organizimit të Njesisë Tapizë , Ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare si dhe Udhëzimin nr.30 Menaxhimin financiar.

Gupi i Auditimit bëri verifikimin në ujëmbledhësin e Tapizës në prani të Përgjegjës të Sektorit ku rezultoi se ky ujëmbledhës administrohej nga njësia e Tapizës por që çuditërisht nuk kishte asnjë lloj aktiviteti siç përshkruhet në rregullore.

II - Bazuar në nenin 281 të ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë” si dhe nenin 248 “Shpërdorimi i detyrës”, të “Kodit Penal të RSH”, **për z.F.M me detyrë ish teknik shërbimi për FBM dhe FEA/B, (gjatë periudhës së auditimit larguar nga puna), për shkelje gjatë viteve 2011-2012, në kundërshtim me ligjin nr.6942, datë 25.12.1984, Udhëzimit nr.70, datë 11.03.1985 me ndryshime, ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 dhe Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, gjë që ka sjellë një dëm ekonomik prej 6,261 litra karburant, në vlerën 1,085,421 lekë,, me person përgjegjës z. F.M**

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT